



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA DURRËS

Durrës 26.01.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

1. A ka nisur Bashkia e Durrësit procedurat për lidhjen e një pensioni familjar me familjen e z. Astrit Hysenaj, për të cilin dyshohet se ka ndërruar jetë gjatë orarit të punës?

Në lidhje me pyetjen tuaj, ju bëjmë me dije se procedura për përfitimin e pensionit familjar nis me paraqitjen e kërkesës nga familja Hysenaj pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. Bashkia e Durrësit është në mbështetje të plotë të familjes së të ndjerit Astrit Hysenaj.

2. Cili ka qenë orari zyrtar i punës i z. Astrit Hysenaj, i cili ushtronte detyrën si punëtor për evadimin e mbeturinave?

Ndërmarrja Komunale Plazh është institucion në varësi të Bashkisë Durrës dhe ushtron aktivitetin e saj në bazë të një rregulloreje të brendshme, e cila mbështetet në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Në këtë rregullore është parashikuar edhe orari zyrtar i punës. Duke qenë një ndërmarrje shërbimi, aktiviteti zhvillohet në tre turne, sipas një grafiku pune të hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit dhe të miratuar nga Titullari i institucionit.

Sipas këtij grafiku, z. Astrit Hysenaj, në datën 06.01.2026, ka qenë i planifikuar në turnin e parë, me orar 06:00–13:00.

3. Sa ka qenë paga mujore e z. Astrit Hysenaj, sipas kontratës së punës në fuqi?

Ndërmarrja Komunale Plazh, si institucion në varësi të Bashkisë Durrës, në përlllogaritjen e pagave të punonjësve bazohet në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 95, datë 28.10.2024, “Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë Durrës”, lidhja nr. 7.

Sipas këtij vendimi, paga mujore e z. Astrit Hysenaj ka qenë 42 500 (dyzet e dy mijë e pesëqind) lekë, klasa IV, si dhe një shtesë për natyrë të veçantë në masën 5 000 lekë. Përlllogaritja e vjetërsisë në punë bëhet sipas pikës “b”, duke përfituar 1% shtesë për çdo vit pune.